



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 77/1 Prot.

Tiranë, më 11. 01. 2018

V E N D I M

Nr. 25, Datë 11. 01. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 65, datë 03.08.2017, e bërë nga Z. A., kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale Fier (në vijim DAR Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*Racës*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

Z. A. sqaron se: “*Kam 5 fëmijë të cilët nuk i dërgoj në shkollë për shkak të pamundësisë ekonomike. I kam rregjistruar dhe dërguar në periudha dy mujore, por i kam shkëputur sërish pasi ekonomikisht e kam të pamundur.*”

Në përfundim, ankuesja ka kërkuar nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ta ndihmojë për të arsimuar fëmijët pasi nuk ka mundësi ekonomike për t’i dërguar në shkollë.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ishte e nevojshme që KMD të dispononte informacion, fakte dhe prova konkrete, që lidhnin trajtimin e pabarabartë dhe disfavorizues, në krahasim me persona të tjerë, në kushte të njëjta apo të ngjashme, me shkakun e pretenduar nga ankuesja.

Në këto kushte, referuar Urdhërit nr. 130, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “*Për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit shtesë në lagjien “1 Maji”, Levan-Fier, lidhur me shqyrtimin e ankesave të shtetasve: R. M., Ç. O. dhe Z. A.*”, ekipi i inspektimit të KMD-së, në datën 03.11.2017, kreu inspektim pranë Lagjies “1 Maji”, ku mori takim me Z. A.

Në vijim të takimit me Z. A. sqaroi se: *“Kam 5 fëmijët të moshave: 11 vjeç, 9 vjeç, 7 vjeç, 5 vjeç dhe vajzën e vogël 7 muajshe. Katër prej tyre mësojnë në shkollën 9-vjeçare në Levan. Për shkak të gjendjes ekonomike nuk mund t'i dërgoj në shkollë. Librat nga shkolla na i kanë dhënë falas, por nuk kam mundësi t'i plotësoj nevojat e tyre me veshmbathje apo ushqime gjatë kohës që ndjekin shkollën. I dërgoj me periudha të shkurtra në shkollë kur kam mundësi, pasi të ardhurat e vetme që kemi janë ato që marrim nga shitja e materialeve të riciklueshme. Në periudhën 2014-2015 kemi kërkuar mbështetje financiare nga Komuna Levan, por nuk kemi përfituar.”*

Ankuesja kërkoi nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndihmë financiare për të dërguar fëmijët në shkollë.

Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 65, datë 03.08.2017, Komisioneri konstatoi se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* përcaktohet një listë josterruese shkaqesh diskriminimi, ku në çdo rast pala ankuese duhet të identifikojë një shkak, në momentin kur paraqet ankesë pranë Komisionerit dhe njëkohësisht të japë argumentimet përkatëse, të cilat të krijojnë një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pabarabartë dhe disfavorizues, që ai pretendon se është ndërmarrë ndaj tij, me këtë shkak diskriminimi.

Në këto kushte, në mungesë të një shkak konkret diskriminimi, si dhe në mungesë të argumentimit përkatës të palës ankuese, që lidh trajtimin e pabarabartë dhe disfavorizues, të pretenduar nga ana e tij, nga ana e DAR Fier, me këtë shkak, nuk është e mundur që të iniciohet procesi i hetimit administrativ.

Gjithashtu, nga informacioni i administruar ankuesja nuk shprehet se i është mohuar ndonjë e drejtë nga ana e DAR Fier, por sqaron se nuk i ka mundësitë ekonomike për të dërguar fëmijët në shkollë. Në këto kushte, ankesa e parashtruar nga Z. A. është çështje nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ku sanksionohet se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, Z. A. nuk ka paraqitur asnjë argument në ankesën e saj ku të identifikojë një të drejtë që i është mohuar për një nga shkaqet që parashikon neni 1 i këtij ligji.

Për sa më sipër, nga pikëpamja formale, Komisioneri vlerësoi se ankesa nr. 65, datë 03.08.2017, e Z. A. nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), parashikohet se :

“Ankesa nuk pranohet nëse:

a).....

b).....

c).....

ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;

Për sa më sipër, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 65, datë 03.08.2017, e Z. A., Komisioneri gjykoi se për rastin konkret nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 2, 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së Z. A., pasi është e papajtueshme me dispozitat e Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, të paraqitet pranë Njësisë Administrative Levan, për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në nevojë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

KOMISIONERI

Irma BARAKU

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)